



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE, E VERIFIKIMIT DHE INTEGRIMIT

Nr. 7625/5 Prot.

Tiranë, më 11 . 02 2022

Lënda: Njoftim

OPERATORIT EKONOMIK “SEAD-SGS” SHPK

**Adresa: Lgj. “Kashar 2”, Rr. “Mullishter”
god. 1 katëshe, nr. pasurie 4, zona
kadastrale 2105, Kashar, Tiranë.**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), në mbështetje të raportimeve periodike dypalëshe të shkëmbyera me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, sipas periudhës përkatëse, ka nisur procedimin administrativ ndaj operatorit tuaj ekonomik, për përjashtimin nga e drejta për të fituar kontrata publike në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Me shkresën Nr. 7625/4 Prot., datë 20.01.2022, APP ju ka nisur një kopje të këtij njoftimi në adresën e shoqërisë tuaj. Kjo shkresë nuk ka shkuar në destinacion dhe është kthyer mbrapsht nga Posta Shqiptare, me justifikimin se, adresa është e panjohur.

Nisur nga ky fakt, APP ka rinisur shkresën e sipërcituar në adresën e dhënë sipas Ekstraktit të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, drejtuar operatorit tuaj ekonomik në datë 26.01.2022, e cila është kthyer përsëri nga shërbimi postar, me të njëjtin justifikim.

Sa më sipër, nëpërmjet këtij njoftimi publik, APP njofton shoqërinë tuaj se, në bazë të parashikimeve të nenit 45 të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, rezervoni të drejtën për t’u njohur me provat e administruara në kuadër të procedimit administrativ të nisur ndaj shoqërisë tuaj, duke dërguar kërkesën me shkrim, ***brenda 5 (pesë) ditëve nga publikimi i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike***, në të kundërt APP do të vijojë procedimin administrativ në bazë të dokumentacionit të administruar.

Duke ju falënderuar,

DREJTORI PËRGJITHËS

